

SHËRBIMET ONLINE TË MFE



Digjitalizimi i shërbimeve publike do të ofrojë lehtësi edhe për qytetarët dhe biznesin. Ministria e Financave dhe Ekonomisë nëpërmjet E-albania ofron 510 shërbime online ose 94 % e shërbimeve nga institucione si QKB, DPT, DPD, ISSH, SHKP. Nëpërmjet tyre reduktohet numri i dokumenteve që duhet të paraqesin aplikantët të cilat sigurohen nga punonjësit e institucioneve. Për të komunikuar këto shërbime online dhe përfitimet për qytetarët, Kryeministri Rama dhe Ministria Denaj zhvilluan një vizitë pranë Agjencisë së Sigurimeve Shoqërore Tiranë. Risi në ofrimin e shërbimeve online të Institutit të Sigurimeve Shoqërore është fakti që reduktohet numri i dokumenteve që duhet të dorëzojnë aplikantët, ku 149 dokumente tashmë sigurohen nga vetë punonjësit e ISSH.

VIZITË ZYRTARE NË KROACI



Ministrja e Financave dhe Ekonomisë zhvilloi një vizitë zyrtare në Kroaci. Gjatë takimeve me homologët kroatë u diskutua mbi zgjerimin e bashkëpunimit ekonomik mes dy vendeve dhe u konfirmua mbështetja e Kroacisë për integrimin e Shqipërisë në BE. Ministria tha se eksperiencia kroatë mbetet shumë e mirë për Shqipërinë në zbatimin e procesit të fiskalizimit, në përthithjen e investimeve të huaja, në zhvillimin e sektorit të turizmit apo edhe në procesin e integritimit si vendi i fundit që ka aderuar në BE. Në takimin me ministrin e Ekonomisë të Kroacisë u premtua mbështetja e qeverisë kroatë për nisjen e procedurave për një linjë direkte ajrore Zagreb-Tiranë dhe bashkëpunimin konkret në fushat si turizëm, transport detar dhe zejtarë.

KONFERENCA “EUROMONEY” NË VJENË



Në konferencën “Euromoney”, në Vjenë, u mbajt paneli i diskutimit për Shqipërinë, i fokusuar në mundësitë e investimit dhe orientimin e tregut shqiptar drejt tregjeve ndërkombëtare, ku mori pjesë Ministria Denaj, së bashku me Guvernatorin Sejko dhe Ministrin Majko. Ministria tha se Qeveria ka përmbyllur me sukses një cikël reformash në fushën e financave publike, ekonomisë dhe arsimit profesional, duke sjellë prej vitit 2013 stabilitet të financave publike, rritje të qëndrueshme të shkëmbimeve tregtare dhe në një trajektore rritëse të investimeve të huaja në vend. Denaj theksoi rëndësinë e avancimit në reformën e sistemit të drejtësisë dhe funksionimit e kadastrës, si dy elementë thelbësorë që do të lehtësojnë më tej të bërit biznes në Shqipëri për sipërmarrësit vendas dhe të huaj.

MARRËVESHJE ME BB PËR FUQIZIMIN E GRAVE



Ministrja Denaj nënshkroi në Vjenë, marrëveshjen me Bankën Botërore për programin e barazisë gjinore dhe aksesin e grave në ekonomi. Marrëveshje ofron një shumë prej 9,1 Milion Eur në funksion të angazhimit të politikave për zhvillim për rritjen e pjesëmarrjes së gruas në tregun e punës dhe kapitalit. Programi në tërësinë e tij është rezultat i bashkëpunimit të Qeverisë Shqiptare me Bankën Botërore dhe Agjencinë Franceze për Zhvillim. Nëpërmjet kësaj marrëveshje synohet intensifikimi i politikëbërjes dhe instrumentave për të mundësuar aksesin e gruas në tregun e punës dhe në tregjet financiare, si një forcë shumë e rëndësishme për të zhvilluar ekonominë, sipërmarrjen dhe për të rritur PBB për frymë. Marrëveshja do të mobilizojë 50 milion euro financim nga Agjencia Franceze e Zhvillimit (AFD) dhe një grant teknik nga AFD për të mbështetur zbatimin e programit.

SAMITI I GRAVE TË BIZNESIT DHE DIASPORËS



Përfshirja e gruas në sipërmarrje dhe politikëbërje është në vëmendjen e plotë qeverisë shqiptare për të reduktuar hendekun gjinor, luftuar pabarazinë, rritur numrin e grave sipërmarrëse dhe aksesin e tyre në financë. Në Samitin e Grave të Biznesit “Takimi i Rrjetit të Grave Profesioniste të Diasporës”, u theksua angazhimi i qeverisë për buxhetimin me bazë gjinore dhe nxitjen e biznesit përmes fondeve dhe granteve të MFE dhe AIDA. Në programin buxhetor 2020-2022 do të ketë 36 programe buxhetore për të mbyllur në mënyrë specifike boshllëqet gjinore ose për të përparuar barazinë gjinore, të cilat do të marrim një vëmendje të shtuar, si pjesë e politikave qeveritare drejt fuqizimit të gruas në të gjithë komponentët e saj dhe atë të sipërmarrjes.

PËRMIRËSIMI I KLIMËS SË BIZNESIT



Ministrja Anila Denaj mori pjesë në takimin e përvitshëm të Dhomës Gjermane të Industrisë dhe Tregtisë, me fokus diskutimin në aktualitetin ekonomik në vend. Ministria vlerësoi bashkëpunimin ekonomik mes Shqipërisë dhe Gjermanisë, si një partner strategjik që ka mbështetur me financime sektorë të ndryshëm të ekonomisë, si ai energjetik, ujësjellës-kanalizime, SME-të, arsimin profesional, përafrimin e legjislacionit me atë të BE-së, etj. Ministria tha se qeveria shqiptare mbetet e angazhuar në përmirësimin e klimës së të bërit biznes në vend dhe përmendi dy prej nismave më të fundit të ndërmarra prej saj, projekti i Fiskalizimit dhe ofrimi i shërbimeve online, të cilat synojnë të lehtësojnë mënyrën e të bërit biznesit dhe ndjesinë e biznesit në raport me klimën e biznesit.

PUNËSIMI PËRMES ZYRAVE TË PUNËS



701 persona janë punësuar në gjithë vendin nëpërmjet ndërmjetësimit të zyrave të Punës gjatë periudhës 4-16 Janar 2020. Numrin më të madh të të punësuarve e ka qarku i Tiranës me 258 persona, i ndjekur nga qarku i Durrësit me 87 persona, qarku i Vlorës me 72 persona, qarku i Fierit me 48 persona, qarku i Elbasanit me 44 persona etj.